

## THIRRJE PËR APLIKIM

### PROGRAMI I PRAKTIKËS PËR JURISTË TË DIPLOMUAR

**Pozita:** Praktikant (40 pozita)

**Kohëzgjatja:** 6 muaj (1 Mars 2019 – 31 Gusht 2019)

**Vendi:** Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj dhe Gjilan

**Lloji i kontratës:** Praktikë me kohë të plotë dhe pagesë (Shuma: 200\$ Bruto/muaj)

#### Mbi programin:

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) është një organizatë e pavarur, jo-partiake dhe jo-fitimprurëse me seli në Prishtinë, Kosovë. Misioni i saj është të zhvillojë hulumtime politike kredibile në fushat e politikës, sundimit të ligjit dhe ekonomisë dhe të shtyjë përpara zgjidhjet e politikave që adresojnë dështimet dhe/ose të trajtojnë problemet në fushat e politikave në fjalë.

GLPS është duke zbatuar projektin e titulluar: "**Nxitja e kërkesës për drejtësi në Kosovë përmes angazhimit të shoqërisë civile**", financuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) (originali: Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs – INL). Qëllimi kryesor i këtij projekti është që të rris rolin e shoqërisë civile në Kosovë që të kontribuoj për qasje më të mirë në drejtësi përmes përfshirjes qytetare në mbikqyrjen e sistemit të drejtësisë. Kjo do rezultoj me një kërkesë më të madhe për qasje në drejtësi dhe llogaridhënie të këtij sistemi, veçanërisht duke ngritur kapacitetet e juristëve të rinjë të diplomuar, përmes programit të praktikës nëpër të gjitha gjykatat themelore në Kosovë.

Mundësitë e praktikës do të jenë në Gjykatat Themelore të Kosovës si në vijim:

Vendi	Numri i praktikantëve
Gjykata Themelore e Prishtinës	14
Gjykata Themelore e Mitrovicës	7 (4 të përkatësisë së komunitetit serb)
Gjykata Themelore e Ferizajit	5
Gjykata Themelore e Prizrenit	4
Gjykata Themelore e Pejës	3
Gjykata Themelore e Gjilanit	4
Gjykata Themelore e Gjakovës	3

### **Kërkesat dhe kualifikimet e nevojshme:**

- Duhet të jenë qytetarë ose banorë të përhershëm të Kosovës;
- Duhet të kenë diplomën në Juridik nga universitetet publike ose private;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi si me gojë ashtu edhe me shkrim në gjuhën shqipe janë të detyrueshme;
- Gjuha shqipe dhe serbe për praktikantët që do të caktohen në Mitrovicën Veriore është një avantazh;
- Njohja e gjuhës angleze është një avantazh;
- Shkathtësi të dobishme të kompjuterit (Word, PowerPoint dhe Excel);
- Njohuri bazike për procedurat ligjore dhe aftësi për të hartuar dokumente ligjore;
- Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të pavarur ose me të tjerët;
- Përvoja e punës në këtë fushë është një avantazh.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të hartoj vendime, aktgjykime dhe dokumente të gjykatës sipas nevojës së gjyqtarëve, administratës dhe stafit të gjykatës;
- Të bëjë hulumtimin / rishikimin e literaturës ligjore në përputhje me nevojat e gjykatës;
- Të ndihmojë në rastet e trajtuara duke marrë shënime, duke siguruar materialin e nevojshëm ligjor dhe duke rishikuar ligjet dhe rregulloret e nevojshme;
- Të sigurojë mbështetje profesionale duke ndihmuar në përgatitjen e memorandumeve, aktgjykimeve dhe dokumenteve të tjera ligjore;
- Të sigurojë mbështetje profesionale për gjyqtarët, drejtuesit dhe personelin e gjykatës;
- Të kryej detyra të tjera profesionale dhe administrative, sipas nevojës së gjykatës.

### ***Si të aplikohet?***

Një aplikim i kompletuar përfshin:

- Rezymenë (CV), maksimum 2 faqe;
- Letër motivuese që tregon interesin në program dhe përvojën përkatëse (maks. 1000 fjalë);
- Transkriptat e notave të universitetit;
- Vërtetimin që nuk është nën hetime.

Ju lutem vini re se të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe ose serbe në formatin PDF në adresën e mëposhtme: [applications@legalpoliticalstudies.org](mailto:applications@legalpoliticalstudies.org) jo më vonë se **8 Shkurt 2019 (Ora 17:00)**. Subjekti i emailit duhet të jetë "2019 GLPS Programi i Praktikës". Aplikacionet pranohen vetëm në mënyrë elektronike.

Asnjë aplikacion nuk do të pranohet/konsiderohet pas mbylljes së afatit për aplikim dhe në çfardo forme tjetër (p.sh. fizikisht, përmes faksit) ose të dërguara në adresa të tjera. Thirrjet telefonike nuk pranohen. Vetëm kandidatët që do hyn në listën e ngushtë do të njoftohen.

Aplikimet inkurajohen nga të gjithë kandidatët e kualifikuar, pavarësisht nga përkatësia etnike, mosha, besimi, aftësia e kufizuar, orientimi seksual dhe identiteti gjinor.



*Ky projekt mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) (origjinali: Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs – INL)*